



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Hiva Org. Org. Unit	06/400	Nr. Prot. Prot. No.	1911/2022
Nr. i kopjeve Prot. shënime No. pages	7	Data Datum Date	21.02.22
PRISHTINËJA			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Department

DATË	16.02.2022
REFERENCË	NR - 12/2022
PËR/ZA/TO:	Z. Nuhi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Z. Remzi Sylejmani, Zv. Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Mitrovicë

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Mitrovicë, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFFT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

#### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen e Kredisë për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Mitrovicë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime.

## OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Mitrovicë, dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj ka kosto totale prej 19,800,000€ për vitet 2022-2026.

Në ndarjet buxhetore të planifikuara me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023 dhe 2024 për projektin në fjalë është paraparë shuma prej 8,000,000€ e cila shumë e shpërndarë në vite dhe kategori të shpenzimeve si vijon.

Kostoja totale e shpërndarë nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve është si vijon:

Kategoria e shpenzimeve	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Totali
Shpenzime kapitale	500,000	2,500,000	5,000,000	8,000,000
<b>Totali</b>	<b>500,000</b>	<b>2,500,000</b>	<b>5,000,000</b>	<b>8,000,000</b>

Shuma prej 11,800,000 € do të planifikohet me projeksionet buxhetore për vitet 2025 – 2026.

### Përfundim:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Mitrovicë, nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2024. Ky projekt është i buxhetuar me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimeve 2023-2024 në shumë prej 8,000,000€ në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht në tabelën 3.2.B dhe do të financohet përmes mekanizmit të klauzolës së investimeve. Meqenëse, vlera e kredisë për projektin në fjalë është në shumë prej 19,800,000€, pjesa prej 11,800,000€ do të planifikohet me projeksionet buxhetore për vitet 2025 – 2026.

Përgatitur nga:

Fëllanza Mekuli, Analiste e lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

